



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.3.2026, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE KLUBIT TË VOLEJBOLLIT
“PRISHTINA 75”

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare KV “Prishtina 75”, për projektin “Ngritja e kapacitetit në fushën e sportit”, për sezonin 2025/2026.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 10,000.00 € (dhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kodi buxhetor i Drejtorisë së Sportit 85086.

III.

Qëllimi i këtij Vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, KV “Prishtina 75”, të cilat Komuna e Prishtinës i ndan si mbështetje financiare për zhvillimin e lojtarëve të të gjitha grupmohave, ngritjen e kapaciteteve profesionale të klubit, duke kontribuar drejtpërdrejt në avancimin e sportit të volejbollit dhe promovimin e vlerave sportive tek të rinjtë.

IV.

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e KV “Prishtina 75” dhe rekomandimi nga komisioni.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/04-47884/26, më 02.4.2026

KRYESUES I KUVENDIT

Fehmi Kurona

